

**VENDIM**  
**Nr.667, datë 28.9.2011**

**PËR KRIJIMIN E FONDIT TË INOVACIONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 7 të ligjit nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin e Fondit të Inovacionit, me vlerë të përgjithshme 40 000 000 (dyzet milionë) lekë, për një kohëzgjatje zbatimi 4 (katër) vjet, për periudhën 2011-2014.

2. Zbatimi i skemës fillon në vitin 2011, me një vlerë prej 4 000 000 (katër milionë) lekësh.

3. Për vitet 2012, 2013 dhe 2014, vlera e fondit është 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë, për secilin vit.

4. Fondi i Inovacionit u jep ndihmë, në formë subvencioni të drejtpërdrejtë, ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, deri në 400 000 (katërqind mijë) lekë. Në varësi të vlerësimit për projektin e dorëzuar nga aplikanti/tët, skema mbulon nga 30% deri 50% të kostove të pranueshme dhe të miratuara, brenda kufirit të lartpërmendur.

5. Kostot e pranueshme, që mund të bashkëfinancohen, përfshijnë kostot për:

a) auditimin e inovacionit dhe të teknologjisë, që synon t’u mundësojë ndërmarrjeve aplikante vlerësimin e pozicioneve të tyre aktuale dhe mundësitë për profilin e tyre të inovacionit dhe/ose pozicionimit teknologjik, sipas një strukture konkurruese zhvillimi;

b) ndërkombëtarizimin e teknologjisë, e cila synon t’u mundësojë ndërmarrjeve aplikante të identifikojnë dhe të inspektojnë teknologjinë që kërkojnë të përshtatin.

6. Përfitojnë nga Fondi i Inovacionit ndërmarrjet, që plotësojnë, veçanërisht, kushtet e mëposhtme:

a) janë biznese, të klasifikuara si mikro, të vogla apo të mesme, sipas ligjit nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar.

b) kanë selinë dhe fabrikën apo fabrikat e tyre kryesore të prodhimit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

c) prodhojnë në Shqipëri produkte dhe/apo shërbime, të cilat tregtohen brenda dhe/apo jashtë vendit.

ç) propozojnë e zhvillojnë veprimtari, brenda programit të përgjithshëm zhvillimor të subjektit, në përputhje me politikën e Fondit të Inovacionit.

d) tregojnë se veprimtaritë e propozuara për t’u mbështetur nga Fondi i Inovacionit janë të rëndësishme për zhvillimin e biznesit të tyre, duke përcaktuar se ato kanë:

i) nevojë për t’u përmirësuar teknologjikisht, për veprimtaritë e propozuara;

ii) një vlerësim për përfitimet e pritshme të biznesit nga përmirësimi, në bazë të të cilit do të zhvillohen veprimtaritë e propozuara;

iii) një plan biznesi apo një projekt, i cili ka të integruar veprimtarinë e propozuar.

dh) argumentojnë se asistencë nëpërmjet Fondit të Inovacionit do të ndihmojë në rritjen e veprimtarisë ekonomike të subjektit përfitues;

e) kanë staf të aftë për zbatimin e duhur dhe në kohë të veprimtarive të propozuara.

ë) janë në gjendje të financojnë 100% të të gjitha kostove të projektit, të propozuara para përfundimit të tij.

7. Pagesa e subvencionit të bëhet në fund të projektit, kundrejt faturës së shpenzimeve të kryera.

8. Procedurat e aplikimit dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve përcaktohen në rregulloren e funksionimit të Fondit të Inovacionit, e cila miratohet nga Bordi i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (më poshtë AIDA).

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përfshihen në buxhetin e

Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e cila krijon një zë të veçantë për këtë qëllim, për llogari të AIDA-s.

10. Për vitin 2011, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të kalojë për institucionin e varësisë, AIDA, shumën 4 000 000 (katër milionë) lekë.

11. Ngarkohet AIDA për menaxhimin e Fondit të Inovacionit.

12. Ngarkohet Ministria e Financave për parashikimin e Fondit të Inovacionit në buxhetin afatmesëm të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për periudhën 2012-2014.

13. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**